



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“Company 21” Sh.p.k.
Numri i biznesit - 70124965
Drejtoreshë – Afërdita KELMENDI
TV 21
Prishtinë

Ref:1811/1248/LIC/ni

VENDIM

për kthimin e kanalit 48 të transmetimit Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale TV 21, me seli në Prishtinë

FAKTET

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. TV 21, është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale, me seli në Prishtinë, i cili është pajisur me licencë afatgjate të KPM-së më datën 6 tetor 2009, për transmetim të programeve televizive në Republikën e Kosovës, me mbulueshmeri nacionale.
3. TV 21, më datën 10 tetor 2018, ka parashtruar një kërkesë me anë të së cilës ka kërkuar nga KPM, kthimin e kanalit 48, të cilin kanal TV 21 e ka shfrytëzuar deri në vitin 2014 për transmetim televiziv analog.

ARSYETIM

4. Në takimin e tij të rregullt, të mbajtur më datën 26 tetor 2018, Komisioni ka vlerësuar se është më e arsyeshme, duke marrë në konsideratë interesin e publikut që të ketë qasje në sinjalet analoge televizive, që TV 21 të shfrytëzojë për transmetim analog televiziv kanalit 48, nga pika e transmetimit në Goleshë, deri në kohën e përfundimit të afatit të licencës për transmetim analog më 28 gusht 2019.

5. Lidhur me këtë qështje, Komisioni i është drejtuar TV 21 me anë të një shkrese, duke e njoftuar me qëndrimin e tij rrethë kërkesës të TV 21 për kthimin e kanalit 48 të transmetimit dhe i ka ofruar mundësi për përgjigje.
6. TV 21, poashtu, me anë të një shkrese ka njoftuar KPM-në se pajtohet plotësishtë me qëndrimin e Komisionit, për kthimin e kanalit 48, Televizionit 21, për transmetim analog televiziv nga pika e transmetimit në Golesh.


VENDIM

7. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 6 dhjetor 2018, merr vendim për kthimin e kanalit 48, Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale TV 21, për shfrytëzimin e tij për transmetim tokësor analog televiziv nga pika e transmetimit në Golesh, deri në përfundim të afatit të licencës për transmetim tokësor analog më 28 gusht 2019.

Lëshimi i Vendimit

8. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Muja FERATI
Kryetar
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



06.12.2018
datë